



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 14-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më
27. 02. 2015 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Albulena Gashi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi, anëtar
19. Ragip Zejnullahu, anëtar
20. Enver Kozhani, anëtar
21. Feriz Hasani, anëtar
22. Ali Stublla, anëtar
23. Valbona Shillova, anëtar
24. Burbuqe Ilazi, anëtar
25. Vlora Buja, anëtar
26. Arben Bahtiri, anëtar
27. Edita Gashi, anëtar
28. Ramiz Qeriqi, anëtar
29. Zoran Çirkovic, anëtar
30. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti Kryetar i Komunës
2. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
3. Shkelzen Hajdini, Drejtor DBF
4. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit
5. Remzi Mehmeti, DMSH
6. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
7. Basri Hashani, Drejtor i DKRS
8. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
9. Heset Sahiti, Drejtor i Sherbimeve Publike
10. Feti Krasniqi, Drejtor i DBZHR
11. Adem Duriqi, Drejtor i Prokurimit
12. Imer Rustemi, Drejtor i Inspektionit
13. Ilir Tasholli, Drejtor i Urbanizmit
14. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës
15. Avni Olluri, Drejtor i Kadastrit
16. Vlora Krasniqi, zyra ligjore
17. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
18. Bekim Krasniqi, "YAHR"
19. Përfaqësuesit e KFOR-it turk
20. Përfaqësuesi i OJQ "Ballkan"
21. Alban Nuredini, Zëdhënës i Komunës
22. Përfaqësuesit e mediave
23. Naser Bytyqi-përkthyes, shqip-serbisht
24. Rifat Hoxha-perkthyes, shqip-serbisht

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezantojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se materialin për rendin e ditës e keni marrë e gjithashtu i keni marrë edhe dy pika tjera dhe kemi plotësimin e rendit të ditës me vendimet siqë janë:

1. Propozimi i Vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen – transferimin e mjeteve financiare dhe
2. Propozimi i Vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan.

Pastaj propozoj që të bëhet edhe renditja e rendit të ditës dhe si pikë e dytë të shqyrtohet raporti i punës së Kryetarit për shkak të disa obligimeve që ka Kryetari të shkoj më herët nga mbledhja. Në vazhdim vuri në votim rendin e ditës së propozuar së bashku me propozimet për plotësim si dhe propozimin për renditjen e pikave siqë i ceki më lartë dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën e votave absolute për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 13-të e KK-së
2. Raporti i punës i Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale për vitin 2014

3. Raporti i Buxhetit të alokuar dhe shpenzimi në bazë të burimit të mjeteve, kategorive ekonomike dhe programeve si dhe planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake për vitin 2014
4. Propozimi i Vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen-transferimin e mjeteve financiare dhe
5. Propozimi i Vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan

Pastaj Kryesuesja pyeti anëtarët e Kuvendit se a ka dikush të thotë diqka para se të kalojmë në punë sipas rendit të ditës së aprovuar.

Ramiz Qeriqi, kam informatë se disa asambleistë kanë shkuar në seminar në Tiranë dhe dashta të pyes pse nuk jemi përfaqësu edhe na nga subjektet më të vogëla dhe dëshiroj të dijë se qfarë kriterë kanë qenë që nuk jemi përfshi na kërkoj përgjigje për këtë.

Meqë pyetje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 13-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 13-të të Kuvendit?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë përkatësisht nuk pati vërejtje, as plotësime Kryesuesja vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi unanimisht

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 13-të të Kuvendit pa vërejtje

Shtesë: Ekstrakti.

II

Raporti i punës i zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve komunale për vitin 2014

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni. i dha fjalën Kryetarit të Komunës Imri Ahmeti i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit.

Pastaj tha se para se të kalojmë te raporti po i përgjigjem Luanit se për këtë seminar ftesa ka qenë nga Instituti demokratik i Kosovës për 5 anëtarë dhe atë 3 nga pushteti 2 nga opozita dhe aty ka qenë edhe struktura gjinore për këtë arsye nuk kemi mund me i përfshi subjektet më të vogla.

Në vazhdim paraqiti fjalën hyrëse lidhur me raportin duke thënë se është i kënaqur me punën që është arritur në vitin 2014 duke pasur parasysh vështirësitë që kanë qenë në këtë vit e siqë e dini edhe ju që nuk ka pas rishiqim të buxhetit. Në vazhdim foli lidhur me realizimin e buxhetit e që është i kënaqshëm.

Pastaj përmendi gjendjen në arsim, shëndetësi rezultate të arritura në administratë si dhe rritjen e të hyrave nga taksat me 100%. Përveq këtyre kemi arritë zvogëlimin e shpenzimeve krahasuar me vitet paraprake. Pastaj tha se sa i përket infrastrukturës në territorin e Komunës së Lipjanit ju e dini se me 2.400,000,00€ sa janë të parapar për investime kapitale na nuk mund të arrijmë një investim të duhur në infrastrukturë.

Pastaj Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, fillimisht përshëndeti Kryetarin dhe të pranishmit në sallë e pastaj falenderoj Kryetarin për raportin një vjeçar të punës duke shtuar se sigurisht edhe në seancat e kaluara kemi qenë të njoftuar me punën e ekzekutivit. Pastaj tha se këtë buxhet nuk e kemi aprovu

na por edhe si i tillë për kundër vështirësive që kemi pasë me që nuk ka pas rishikim të buxhetit na e kemi realizu. Pastaj foli për të arriturat në arsim siqë janë futja e të gjithë punëtorëve të arsimit në listat e pagave, fillimi i pagimit të borxheve që kanë mbetë në arsim pastaj tha se të arriturat në Shërbime Publike, në shëndetësi, realizimi i të hyrave buxhetore dhe tejkalimi i planifikimit të buxhetit, përforma në administratë të gjitha këto janë pika që jemi marrë gjatë tërë vitit dhe me zhvillimet që janë bërë dhe unë inkurajoj ekzekutivin që edhe në të ardhmen të vazhdoj me këtë përformancë.

Florent Hoxha, ne si grup parlamentar i PDK-së e kemi shqyrtu këtë raport dhe kemi konstatu se ka pasur progres por jo në të gjitha lëmitë e gjithashtu në disa raste ka pasur shkelje të Ligjit si në emërimin e Nënkyetarit, ndërimi i vendeve të punës të shërbyesve civil si dhe largimi nga puna të Liman Boshnjakut etj. Në vazhdim bëri leximin e fjalës të përgatitur me shkrim që është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Arben Bahtiri, e dëgjuam fjalën e Florentit ku ndër tjera foli lidhur me ndalimin e migrimit të popullatës e që mendoj që kjo dukuri nuk është vetëm nga viti i fundit por është si pasojë e keqëqeverisjes në vitet e mëhershme. Në vazhdim tha se për kundër buxhetit që e kemi trashëguar me 7 milion borxhe Kryetari dhe ekzekutivi ja kanë dalë që në vitin 2014 ta përmbyllin me sukses me investime kapitale gjithashtu në shëndetësi dhe në arsim. Pastaj tha se vlenë të përmendet zvogëlimi i shpenzimeve si te derivatet e naftës, te telefonit dhe shpenzime tjera që krahasuar me vitet e kaluara janë shumë më të vogëla. Pastaj përmendi të arriturat nëpër Drejtorate e posaqërisht në Drejtoratin e arsimit duke e ditur se si e kanë marrë gjendjen në këtë Drejtorat. Në vazhdim kërkoi që në të ardhmen të ketë subvencione më shumë për fermer, kulturë rini dhe sport. Në fund tha se kjo qeverisje ka filluar mbarë në vitin 2014 dhe uroj që edhe në vitin 2015 të ketë suksese edhe më të mëdha.

Nehat Tërpeza, sot në këtë seancë po e shqyrtojmë një raport për punën që kemi lënë pas ku shihet se rezultatet janë pozitive duke pasur parasysh gjendjen që e kemi marrë. Në vazhdim tha se në arsim e dimë të gjithë se një numër i madh të punëtorëve të arsimit ka qenë jasht listës së pagave pastaj bëri leximin e fjalës të përgatitur me shkrim.

Blerim Gashi, falenderoj Kryetarin për paraqitjen e raportit detal për punën për vitin 2014. Para se me hy në vlerësim dua të theksoj se na të gjithë e dimë se ka qenë një vit i vështirë e për kundër saj Kryetari ka arritë me e përmbull të suksesshëm këtë vit. Dihet se për vitin që po flasim ka pasur një punësim më të madhe por jo edhe sa kemi dashtë ne. Sa i përket migrimit dihet se në vitin 2014 ka qenë migrimi më i madh por kjo dukuri është shfaqë si pasojë e mos sukseseve në vitet e mëherëshme. Sa u përket projekteve lirisht po them se janë kryer me një buxhet më të vogël krahasuar me vitet e kaluara dhe kjo flet se kjo qeveri i ka thënë stop korrupsionit dhe kjo mënyrë e qeverisjes i duhet edhe Komunës por edhe qeverisë qendrore. Sipas raportit shihet se në çdo lëmi ka arritje por është normale që opozita ka vërejtjet e veta dhe ne urojmë që edhe në të ardhmen të vazhdoj kjo punë. Kryetari tha se Komuna e Lipjanit nuk ka pasur përkrahje edhe më heret por edhe tani nga niveli qendrorë, por ne duhet të angazhohemi që të kërkojmë më shumë mjete nga qeveria për investime kapitale. Pastaj pyeti se rruga 4 korsi a do të vazhdoj dhe kur do të përfundoj e gjithashtu edhe objekti i gjimnazit kur do të përfundoj. Në fund tha se me 6 mars është një konferencë me donatorë dhe unë propozoj që të konkurohet në projektin e Sitnicës në ndërrimin e gypave të ujësjellësit.

Labinot Shahini, Florenti foli për emërimin e Nënkyetarit për Komunitete si dhe kritikoj punën e disa sektorëve, por unë i kisha sygjerru që për qështjen e Nënkyetarit të flet dikush tjetër e jo Florenti meqë ka qenë vetë në atë pozitë. Sa i përket kritikave për sektorët unë po them se në vitin 2014 në të gjitha sektorët ka pasur arritje më shumë se në vitin paraprak që kanë udhëhequr këta.

Linda Shahini, unë kisha me u ndalë te pronat komunale dhe nuk e di se a e din Florenti që Komuna për herë të parë ka formu një komision për dhënien e pronave në shfrytëzim dhe të gjitha

lokalet janë dhënë në baza ligjore dhe cili ofertues ka dhënë më së shumti e ka fituar lokalin dhe lokalet nuk janë dhënë me preferencë të Kryetarit siqë janë dhënë më herët.

Enver Kozhani, tha se ne si grup parlamentar e kemi shqyrtu këtë raport dhe e kemi analizu e gjithashtu kemi përcjellë punën e ekzekutivit për vitin 2014. Në vazhdim lexoi fjalën e përgatitur me shkrim lidhur me raportin e punës së zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve i cili raport është pjesë përbërëse e procesverbalit.

Vlora Buja, foli lidhur me shkeljet në DKA gjatë pranimit të kuadrit mësimor për të cilat shkelje tha se i ka konstatu edhe inspektorati regjional i arsimit nga Ferizaji gjatë inspektimit me 16,17 dhe 22 shtator 2014 ku sipas tyre pranimi i kuadrit mësimor është bërë në kundërshtim me ligjin e gjithashtu në kundërshtim edhe me konkursin e shpallur. Në vazhdim bëri leximin e materialit të përgaditur me shkrim lidhur me raportin e punës së Kryetarit i cili material është pjesë përbërëse e procesverbalit.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, unë po ndalem te kjo pyetje e fundit te arsimit dhe po them se një e drejt e fituar padrejtësisht kur i merret dikujt atëherë gjithëmonë duket e madhe. Riparimet nuk janë të lehta dhe më lehtë e ndërton një objekt të ri se sa me e meremetu dhe arsimin e kemi gjet llom andaj ju lutem mos folni për arsim ku të gjithë e dimë se për 6 vjet kurr nuk keni shpall konkurs dhe gjendja ka qenë llom në arsim. Gjatë diskutimeve e that se e kam marrë mikun e vëllaut në arsim a gjatë mandatit të kaluar Kryetari i mëparshëm e ka pranuar vëllaun në punë, Nënkryetari vëllaun, Drejtori i arsimit ka marrë në punë djalin, vajzën etj. Mua nuk po më pëlajnë këto diskutime që po bëhen për inati se kjo si shoqëri nuk na qonë përpara e gjithashtu nuk po më vjen mirë as LDK-ja që po më mbronë mua dhe nuk ban me më mbrojtë nëse e kam keq. Pastaj tha se nuk është mirë që këtu të lexohen vjersha që lexoi Vlora dhe po i tregoj se nuk është Faik Marevci që po e përmendi por është Faik Retkoceri dhe në atë vendë pune kanë qenë dy kandidat të njëjtë dhe është marrë kandidati që ka më shumë përvoj pune Naim Zeneli. Normalisht ka gabime dhe na jemi njerëz por nuk do të thotë se na jemi në pushtet dhe për këtë arsye nuk mund të punësohen familjarët tonë me që edhe kur ka qenë Shukriu nuk ma ka marrë vëllaun.

Nga Enveri u dhanë disa vërejtje dhe përmendi shtrurjen e disa plakave dhe unë ju them se nuk jam ekspert dhe kam angazhuar ekspertët për këtë çështje, akuzë tjetër ishte për objektin e Qendrës rinore në Magurë a nuk e përmendi sallën në Shalë që është nisë ndërtimi i saj që 6 vjetë dhe nuk ka përfunduar, gjithashtu kanalizimi në Gadime është fillu që 6 vjet dhe ende nuk është përfunduar dhe për këto që si keni kryer ju nuk i përmendni fare.

Ishte një pyetje nga Blerimi se me cilat projekte do të konkurojmë në konferencën e donatorëve dhe unë ju them se kemi 3 projekte si vijon:

- Projekti i ndërtimit të infrastrukturës për qendrën ekonomike
- Projekti i ndërtimit të objektit të Komunës dhe
- Projekti i rregullimit të shtratit të Lumit "Sitnica"

Prej këtyre sigurisht një projekt do të kalon.

Lidhur me këto po ju informoj se kemi kërku nga APK-ja që te ish Auto shkolla në hyrje të Lipjanit ku kemi një parcelë dhe kemi kërku që kjo parcelë të bashkohet me një parcelë që është në menagjim të AKP-së për ndërtimin e objektit të Komunës.

Pastaj tha se unë jam Kryesues i rrjetit të asociacionit të Agjensisë zhvillimore të vendit dhe jam shef i AAD-së e njëherit jam udhëheqës i atij panairi.

Florenti foli në mënyrë kritike dhe kuptohet se është opozitë dhe është normale me dhënë kritikë dhe sygjerime por është edhe normal që Kryetari i Komunës me pasë zëdhënësin e tij dhe stafin tjetër dhe ju them se 3 përfaqësues nga asosacioni i komunave kemi qenë te ish Kryeministri dhe kemi kërku që Kryetarët e komunave të kenë stafin e vet prej 5 vetave siqë është shoferi, asistentja, shefi i kabinetit, zëdhënësi dhe ky staf është politik vjen me Kryetarin dhe pas përfundimit të mandatit të Kryetarit shkojë me Kryetarin, me përjashtim të zëdhënësit i cili ende është staf civil dhe pritët me hy si staf politik.

Te çështja e pagave ju njoftoj se së shpejti do të ketë një standardizim për vendet e punës në administratë në nivel të vendit dhe ky standardizim do të bëjë edhe nivelizimin e pagave dhe këtu do të ketë edhe zvogëlim të stafit civil. Unë dëgjova edhe për shëndetësi ku nga buxheti i Komunës ne i kemi nda 20 mijë euro për barna që nuk kemi pas obligim si komunë dhe këto i kemi nda në saje të kursimeve që kemi bërë.

Unë edhe njëherë po ju ftoj që t'i shikojmë çështjet makro dhe nuk e di sa e kuptoni se qka është kjo makro por duhet të shikojmë se a është realizu buxheti po, gati 100%, a janë realizu shpenzimet, po, a ka ndonjë tender që është anulë, ska, a ka ndonjë lëndë që e ka marrë hetuesija, ska, a ka ndonjë punëtor i arsimit që është jashtë sistemit të pagave, ska. Këto janë të arritura që duhet t'i shihni. Në vazhdim tha se nuk është lehtë me i përmbyll projektet që kanë mbetur në gjysëm.

Te subvencionet ju njoftoj që edhe ju e dini që 70 mijë euro janë shpenzu për Bashkësinë Islame për shpenzimet e varrimit, 50% të subvencioneve, dhe nuk kemi pasë mundësi me investu sa duhet në sektoret tjerë. Në vazhdim përmendi disa vendime të ish pushtetit për ndarjen e mjeteve OJQ" YAHR-së " dhe normalisht kur i ndalet ky burim atëherë flet edhe keq dhe neve më mirë na ka rënë që me mjetet nga subvencionet kemi qitë 15 kulme të shtëpive se sa me ju dhënë OJQ-ve.

Ishte një pyetje tjetër për rrugën 4 korsi në këtë vit kemi parapa 350 mijë euro dhe do ta vazhdojmë deri te rruga e ambullantës.

Gjatë diskutimit të Kryetarit pati ndërhyrje disa herë nga përfaqësuesi i OJQ-së "YAHR" dhe pas këtyre ndërhyrjeve reagoi Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni e cila kërkoi nga përfaqësuesi i OJQ-së që të rri si duhet në sallë dhe mos të ndërhyr ose të liron sallën me që askush nuk i ka dhënë fjalën. Edhe për kundër tërheqjes së vërejtjes 2-3 herë pati ndërhyrje të përfaqësuesit të OJQ-së dhe pas kësaj Kryesuesja kërkoi që i njëjti ta liroë sallën dhe pas disa minutave përfaqësuesi i OJQ-së lëshoi sallën.

Burbuqe Ilazi, pyeti se sa kanë migruar nga Komuna e jonë dhe sa është numri i nxënësve.

Florent Hoxha, shumica që i thash më lart janë të vërteta dhe nuk i thash për inati.

Nga Labinoti u tha që mos të diskutojmë për pozitën e Nënkryetarit për komunitete por unë po them se qdo herë jemi kritiku për këtë pozitë nga opozita dhe nëse na atëherë kemi gabu ju mos gaboni sot.

Te subvencionet po them se duhet me qenë transparente dhe na e pamë se janë ndihmu për ndërtim të disa shtëpive por kërkoj që me kohë të janë transparente dhe mos të shkohet në baza partiake. Në arsim ka pasur probleme dhe mos pagesa por krejt kjo ka ardhur për shkak të rritjes së numrit të lehonive e që sigurisht ka pasur edhe lëshime sikurse që ka edhe sot.

Në Kraishtë me histori është pranë si mësues pa konkurs pyes Drejtorin a është shkelje ligjore kjo. Për OJQ "YAHR" Kryetari paraqiti disa vendime për ndarjen e mjeteve nga subvencionet por unë nuk e di se janë dhënë aq shumë mjete për këtë OJQ.

Feriz Hasani, kërkoi që në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të diskutohet si pikë e veçantë çështja e legalizimit të objekteve se Ligji është i mirë por në rrethanat tona duket se është i pa zbatueshëm në praktikë.

Ragip Zejnullahu, disa herë është përmend prokurimi dhe u tha se kontratat në qeverisjen e kaluar kanë tejkaluar planifikimin por këto nuk janë të vërteta meqë qdo kontratë që është lidhur ka qenë nën planifikimin duke i përmendur me emëra projektet kontratat.

Xhevat Olluri, gjatë diskutimeve dua t'i veqoj dy prej tyre që më pëlqyen dhe ishin racionale, diskutimi i Kryetarit kur tha mos më mbronin dhe diskutimi i Florentit kur tha se nëse kemi gabuar na ju mos gaboni.

Ramiz Qeriqi, unë e respektoj punën e vitit të kaluar dhe është dallim i madh i punës me vitet e mëhershme. Pastaj tha se kam vërejtje të shtruarja e trotuareve që ende pa u bërë pranimi kanë filluar me u gërvish pllakat andaj kërkoj nga Kryetari që të bëhet një mbikëqyrje më e madhe se me qfarë materiali po punohet.

Prej tri projekteve që u përmenden propozoj që projekti i "Sitnicës" të jetë numër një ndërsa sa i përket projektit për objektin e Komunës propozoj që këtij projekti t'i bashkangjitet edhe një projekt për një objekt për çështje sociale. Te seminari në Tiranë që e përmendi Kryetari më herët që tha është dashtë me e respektu barazin gjinore unë e analizova këtë dhe e pashë edhe këtu ka pasur mundësi që të mirret një femër nga subjektet tjera.

Me që diskutime tjera nuk pati Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni propozoj që të kalohet në pikën e tretë.

Shtesë: Raporti.

III

Raporti i Buxhetit të alokuar dhe shpenzimi në bazë të burimit të mjeteve, kategorive ekonomike dhe programeve si dhe planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake për vitin 2014

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni. i dha fjalën Shkelzen Hajdinit, Drejtor i DBF-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti i alokuar dhe shpenzimeve i cili raport është pjesë përbërse të këtij procesverballi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe pastaj tha se raportin e buxhetit si dhe të shpenzimeve e kemi marrë me kohë e gjithashtu edhe Drejtori e elaboroj mirë këtë raport. Realizimi i buxhetit nga granti qeveritar me 99% është i mirë edhe pse ka tepër një shumë e vogël ato i kthehen qeverisë kurse realizimi i të hyrave vetanake ka pasur rritje dhe mjetet që nuk kanë arritë të shpenzohen nga të hyrat vetanake ato mund të barten në vitin e ardhshëm dhe nuk shkojnë në suficit. Në vazhdim përmendi rritjen e të hyrave vetanake si nga lejet e ndërtimit që është një rritje e madhe ashtu edhe nga qiraja si dhe tatimit në pronë.

Feriz Hasani, duhet të jemi real se në të ardhmen të hyrat nga objektet pa leje nuk do të jenë sikur tani ndërsa te të hyrat nga qiraja janë të hyra të cilat nuk janë paguar më herët me vite të tëra dhe kjo ka ndiku që te kjo kategori të ketë rritje.

Ali Stublla, Drejtori gjatë diskutimit përmendi disa herë të hyrat nga lejet e ndërtimit dhe kuptohet se lejet e ndërtimit i marrin ata që kanë parë dhe në sajë të tyre janë rritë të hyrat e Komunës dhe kemi qenë pesë kompani që kemi marrë leje ndërtimi dhe së paku është dashtë të na i qesin nga një kafe.

Florent Hoxha, edhe ne si grup parlamentar e kemi shqyrtu këtë raport dhe kemi disa shqetësime tona me që buxheti te disa kategori te shpenzimet nuk janë realizu si duhet dhe kemi kategori ku realizimi i shpenzimeve është bërë vetëm 75%. Sa i përket mjeteve nga granti qeveritar për investime kapitale realizimi është mbi 91% këtu është mirë edhe pse kanë mbetë pa u shpenzu 54 mijë euro e dihet se këto mjete shkojnë në suficit por nuk janë mjete të mëdha.

Te të hyrat vetanake kemi mbetje prej 500 mijë euro që është një shumë e madhe dhe nuk e dimë pse ka mbetë kjo shumë pa u realizu.

Pastaj përmendi mbetjet te pozicioni për paga dhe meditje ku kanë tepër 15 mijë euro dhe propozoj që në të ardhmen mjetet që planifikohen në këtë pozicion të shpenzohen meqë dihet se shkojnë në suficit. Në vazhdim kërkoi që meditet e anëtarëve të komiteteve të paguhen.

Blerim Gashi, unë dola me i dhënë përkrahje këtij raporti meqë sipas këtij raporti shihet se është një nivel i mirë i të hyrave e gjithashtu edhe i shpenzimeve. Unë edhe më herët e kam cek që mjetet mos të na shkojnë në suficit dhe kjo është realizu.

Edita Gashi, fillimisht përshëndeti të pranishmit pastaj tha nga ky raport mund të konkludojmë se edhe planifikimi i mjeteve nuk ka qenë i mirë sipas kategorive ekonomike ku shihet se nga investimet kapitale 630 mijë euro nuk janë shpenzuar dhe unë mendoj se nevojat e qytetarëve janë shumë të mëdha andaj është e pa pranueshme që të na teprojnë mjete.

Imri Ahmeti, sa i përket medetjeve të Komiteteve kemi problem se ka disa ligje që na obligojnë me i formu komitetet kurse në anën tjetër nuk na lejon me i futë në sistem të pagave.

Rritja e të hyrave nga lejet e ndërtimit është bërë për shkak se nuk kam leju të ndërtohet asnjë objekt pa leje.

Te legalizimi i objekteve mos mendoni se të gjitha objektet e ndërtuara pa leje do të legalizohen.

Te shpenzimi i mjeteve ju duhet ta dini se mjete që grumbullohen në dhjetor nuk mund të shpenzohen por ato bartën në vitin e ardhshëm dhe nuk shkojnë në suficit dhe këtë duhet ta keni parasysh dhe mos pyetni pse nuk janë realizu.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim raportin e buxhetit të alokuar si dhe shpenzimet në bazë të burimeve të mjeteve të kategorive ekonomike dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për 1 kundër

Aprovoi

Raportin e Buxhetit të alokuar dhe shpenzimi në bazë të burimit të mjeteve, kategorive ekonomike dhe programeve si dhe planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake për vitin 2014.

Shtesë: Raporti

IV

Propozimi i Vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen-transferimin e mjeteve financiare

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Drejtorit të DMSH-së, Remzi Mehmetit i cili në vazhdim tha se Njësia profesionale e zjarrëfikësve i ka parashtruar kërkesë Kryetarit të Komunës me të cilën ka kërkuar ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 3.000,00€ në emër të Salih Jakupi nga Ribari i Madh për shpenzimet e transportimit të automjetit – Kamion i zjarrfikësve i tipit “Mercedes” 608D nga Gjermania i cili është dhënë donacion nga Qytetit Sinsheim i Gjermanisë.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për 1 apstenim miratoi këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN – TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen – transferimin e mjeteve financiare në shumë prej 3000 €, (tre mijë) euro në xhirollogarinë bankare të Salih Jakupit (person i autorizuar nga Komuna) i cili do t'i kryej të gjitha shërbimet dhe pagesat për transportimin automjetit - kamionit të zjarrëfikjes “ Mercedes” 608D nga qyteti Sinsheim i Gjermanisë në qytetin e Lipjanit, sipas Kërkesës së Drejtoratit për Mbrojtje dhe Shpëtim – Njesisë së zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Lipjan .

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere të planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2015.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

V

Propozimi i Vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Basri Hashani Drejtor i DKRS i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni hapi shqyrtimin?

Daut Azemi, unë dola këtu me i dhënë mbështetje këtij Vendimi meqë na kemi një vendim për caktimin e çmimit të shpenzimeve të varrimit. Në vazhdim tha se për të ardhmen propozoj që kjo përgjegjësi t'i delegohet Kryetarit në mënyrë që Kuvendi mos të mirret me këso Vendime.

Xhevat Olluri, ne e dimë të gjithë se kjo çështje po përseritet çdo herë dhe propozimin e Dautit e kuptoj mirëpo është mirë që kjo çështje po shqyrtohet në Kuvend dhe po shkon përmes Kuvendit. Në vazhdim tha se edhe më herët kam propozu që të kemi një Rregullore për varreza ku do të rregullohen në mënyrë precize këto çështje. Gjithashtu tha se ekziston edhe një mundësi tjetër që këto punë të ipen me tender kompanive të specializuara dhe ajo kompani që është më e lira e fiton tenderin. Përveq saj ekziston edhe mundësia tjetër që me kërkesat e familjarve të ipen këto shpenzime e sidomos rasteve sociale dhe konsideroj se ata që i kanë kushtet e mira nuk do të parashtrojnë kërkesë fare për këto shpenzime.

Blerim Gashi, na këtë Vendim duhet ta aprovojmë se kemi hy në obligime dhe konsideroj se për të ardhmen këtë shërbim duhet ta rregullojm me Rregullore të veçant.

Ramiz Qeriqi, shumë herë kemi dhënë propozime por tani propozoj që këto mjete të mbesin në zyrën e Kryetarit dhe Kryetari t'i paguaj shpenzimet sipas kërkesave të parashtruara duke e dokumentuar me çertifikatën e vdekjes.

Florent Hoxha, na si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim këtë propozim Vendim por kërkoj që Drejtorati i Shërbimeve Publike në bashkëpunim me DKRS-në të hartojnë këtë Rregullore në mënyrë që mos të merremi çdo herë me këtë çështje.

Sefer Tasholli, Nënkryetar i Komunës, tha se ekziston Rregullorja për varreza e cila është hartu në vitin 2005 e që është bazuar në ligjet e vjetra të KSAK-së, andaj duhet të bëhen disa modifikime e gjithashtu kësaj Rregullore duhet t'i shtohen edhe disa nene ku do të përfshihen shërbimet mortore.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për asnjë kundër asnjë apstenim miratoi këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan në shumë prej 6050 €, (gjashtë mijë e pesëdhjetë euro) euro për subvencionim të shpenzimeve të varrimeve, për 55 raste të vdekjes të cilat kanë ndodhur prej datës 24.12.2014 deri më 16.02.2015 nga 110 Euro për secilin rast $55 \times 110 = 6050$.

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të subvencionohet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2015.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 13,³⁰

***Ekstraktin e hartoi
Sami Murati***

***Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni***